

VENDIM
Nr.74, datë 29.12.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Hilmi Dakli,	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar	i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar	i “““
Bardha Selenica,	Anëtare	e “““
Kristofor Peçi,	Anëtar	i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar	i “““
Kujtim Puto,	Anëtar	i “““

me sekretare Noela Ruço, më datën 2.12.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.69 Akti që i përket:

K Ë R K U E S : SEFER REÇI, i përfaqësuar nga avokat Ermir Dobjani.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

- 1.KËSHILLI I RRETHIT TIRANË, në mungesë.
- 2.SAIM DEMNERI, përfaqësues i trashëgimtarëve të Hajrije Reçit (Kazazi), përfaqësuar nga avokat Gjergj Sauli.
3. BESNIK BOGDANI, përfaqësues i trashëgimtarëve të Mahmut Bogdanit.

OBJEKTI:

Shpallja antikushtetues e vendimit nr.1145, datë 20.10.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, bazuar në nenet 38 e 40 të Ligjit nr.7692, datë 31. 3.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

Kërkuesi ka parashtuar këto shkaqe për shpalljen antikushtetues të vendimit të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit :

Çështja është administrative, prandaj duhet ta gjykonte kolegji administrativ dhe jo kolegji civil. Një qëndrim i tillë vjen në kundërshtim me nenet 1 e 5 të Ligjit nr.8362, datë 10. 7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Kasacionit dhe administrimin e sheshimeve gjyqësore”.

Gjykimi nga kolegji civil dhe jo administrativ, është gjykim jo i drejtë nga një gjykatë jo kompetente, sipas nenit 38 të Ligjit nr.7692, datë 31. 3.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Kjo përbën gjithashtu një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 38 të po këtij ligji.

GJYKATA KUSHTETUESE ,

pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Shkaqet e parashtuara nga kërkuesi nuk mund të sjellin shpalljen antikushtetues të vendimit nr.1145, datë 20.10.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

Çështja me palë paditëse Sefer Reçi etj, dhe të paditur Komisioni i Kthimit të Pronave, trashëgimtarët e Hajrije Reçit e Mahmud Bogdanit e me objekt anullimin e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave e detyrimin për njohje pronësie është gjykuar në Gjykatën e Kasacionit sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile, prandaj nuk jemi përpara një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 38 të Ligjit 7692, datë 31. 3.1993 “Për të drejtat e liritë themelore të njeriut”.

Gjykata e Kasacionit është jo vetëm organi kompetent që shqyrton rekursat ndaj vendimeve të instancave të tjera gjyqësore, por edhe organi që në zbatim të detyrës për interpretimin e ligjit dhe njehsimin e praktikës gjyqësore përcakton natyrën e mosmarrëveshjes dhe kolegjin kompetent për gjykimin e çështjes në zbatim të ligjit nr.8362, datë 1.7.1998 “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës së Kasacionit dhe administrimin e shërbimeve gjyqësore”.

PËR KËTO ARSYE ;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15. 7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.